



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

Edicion i VII-të

BULETINI INFORMATIV

(Korrik, gusht, shtator 2021)

Në këtë edicion, ndër tjerash,
mund të lexoni:

- Prezantohen instrumente të reja të legjislacionit dytësor të konkurrencës
- AKK drejt një organizimi të ri të brendshëm
- Ndërmerren masa për të parandaluar ngritjen e çmimeve gjatë stinës së verës
- Shtojcë 1 Mëso për konkurrencën: Procedurat e hetimi të konkurrencës



Funded by
the European Union



NDËRMERREN MASA PËR TË PARANDALUAR FIKSIMIN E ÇMIMEVE GJATË STINËS SË VERËS

Në kuadër të përpjekjeve për të siguruar një konkurrencë të drejtë në tregun e Kosovës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në vazhdimësi monitoron sjelljen e operatorëve të cilët afarojnë në tregje të ndryshme. Sidoqoftë, një monitorim i tillë është veçanërisht i nevojshëm gjatë stinës së verës, për shkak të tendencës së disa sektorëve për të fiksuar çmimet e shërbimeve dhe produkteve të caktuara, në kohën kur mërgata është duke kaluar pushimet në vendin tonë.



Për këtë arsye, qysh në fillim të verës, AKK është siguruar që të ndërmarrë masa për të parandaluar një dukuri të tillë. Kjo është bërë qoftë duke takuar përfaqësues të sektorëve të ndryshëm, apo duke informuar pjesëmarrësit e tregut se fiksimi i çmimeve përben shkelje të rëndë të konkurrencës.

Fiksimi i çmimeve përmes praktikave të bashkërenduara ua pamundëson qytetarëve të kenë llojshmëri të çmimeve për një produkt apo shërbim të caktuar. Për këtë arsye, edhe Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës parashih gjoba të larta ndaj atyre që veprojnë jashtëligjshëm.

Më 17 korrik, AKK ka lëshuar një komunikatë për media për të informuar publikun e gjerë lidhur me këtë çështje. Këtë thirrje publike, AKK e ka bazuar në mandatin e tij për të avokuar sa më gjerësisht për politikën e konkurrencës dhe vetëdijesimin e akterëve në treg për dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Para kësaj, më 13 korrik, zyrtarë të AKK-së, në bashkëpunim me zyrtarët e Komunës së Rahovecit dhe asaj të Kaçanikut, janë takuar me përfaqësues të floktarëve të këtyre komunave, për të diskutuar lidhur me paralajmërimet për një ngritje të bashkërenduar të çmimit të shërbimeve që ofrohen në këtë sektor.

Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë që të njoftohen përfaqësuesit e këtij sektori se ngritja e bashkërenduar e çmimeve ndërmjet operatorëve përben shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Në këtë kontekst, përfaqësuesit e floktarëve të kësaj komune janë zotuar para zyrtarëve të AKK-së dhe zyrtarëve të Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Kaçanikut se nuk do ta zbatojnë një marrëveshje të tillë mes operatorëve për ngritje unanime të çmimeve.

PREZANTOHEN INSTRUMENTE TË REJA TË LEGJISLACIONIT DYTËSOR TË KONKURENCËS

Katër draft-udhëzues dhe ndryshime në tri instrumente të legjislacionit dytësor që ndërlidhen me draftligjin e ri për Mbrojtjen e Konkurrencës janë prezantuar para drejtuesve të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK) në një tryezë të mbajtur më 20 shtator.

Draftimi i këtyre dokumenteve si dhe kjo tryezë janë pjesë e përkrahjes që Projekti "Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore" i ofron AKK-së në fushën e zhvillimit legjislativ, që më herët ka përfshirë edhe përkrahje përbajtësore në përgatitjen e draftligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së, z. Sakip Imeri, ka thënë se ky është një aktivitet i rëndësishëm, të cilit i kanë parapri aktivitetet e përbashkëta dhe debatet për hartimin e draftligjit dhe harmonizimit me direktivat e BE-së për Konkurrencën. Sipas tij, draftligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është pjesë e agjendës legjislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2021 dhe pas miratimit nga qeveria në mënyrë që ai të dërgohet në Kuvendin e Kosovës.

Gjithsej 15 instrumente të legjislacionit sekondar do t'i dorëzohen AKK-së gjatë muajve të ardhshëm.

Draft-udhëzimet e prezantuara para AKK-së përfshijnë draft udhëzimin për përcaktimin e pozitës dominuese, draft udhëzimi mbi abuzimin me pozitë dominuese dhe draft udhëzimet mbi vlerësimin e efekteve të përqendrimeve horizontale dhe jo horizontale. Në anën tjetër, amendamente specifike janë propozuar në këto instrumente të legjislacionit dytësor: Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2012 mbi format e paraqitjes së kërkesave dhe kriterëve për përcaktimin e përqendrimit të ndërmarrjeve, në Rregulloren Nr. 04/2018 mbi Rregullat e procedurës së Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

Projekti tani do të vazhdojë me draftimin e tetë instrumenteve të tjera që lidhen me draftligjin e ri, dhe të organizojë diskutim për 15 ndryshimet legjislative të propozuara me Komisionin e ri të Autoritetit Kosova të Konkurrencës, sapo këta anëtarë të emërohen.

NEW ARTICLE 3B - Calculation of Turnover

- Provisions on calculation of turnover should be clear and unambiguous for enterprises in order to enable them relatively easily to evaluate if a particular transaction is notifiable as a concentration.
- The most complicated issue usually is the calculation of the turnover of an enterprise belonging to a group of related enterprises. To this end, elaborate explanations and a relevant scheme are provided.

The diagram illustrates a corporate structure with the following ownership relationships:

- Entity 'c1' owns 100% of 'c'.
- Entity 'g' owns 100% of 'd'.
- Entity 'c' owns 80% of 'a'.
- Entity 'g' owns 30% of 'a'.
- Entity 'a' owns 91% of 'b'.
- Entity 'a' owns 91% of another 'b'.
- Entity 'a' owns 100% of 'x'.
- Entity 'b' (under 'a') owns 100% of 'b1'.
- Entity 'b' (under 'a') owns 100% of 'b2'.
- Entity 'b' (under 'a') owns 80% of 'e'.
- Entity 'x' owns 30% of 'b3'.
- Entity 'e' owns 30% of 'b3'.

MBAHEN DY TRAJNIME DY-DITORE PËR POLITIKAT E KONKURENCËS



Zyrtarët e AKK-së kanë marrë pjesë në dy trajnime të zhvilluara gjatë muajit shtator në kuadër të Programit për Trajnime për Ligjin dhe Politikat e Konkurrencës, të organizuar nga Projekti **MBËSHËTETJA E BE-SË PËR AUTORITETIN KOSOVAR TË KONKURENCËS DHE KOMISIONIN E NDIHMËS SHËTETËRORE**, përfitues kryesor i të cilit është AKK.

Trajnimi i parë, i mbajtur më 15 dhe 16 shtator, është përqendruar në tema që ndërlidhen me pozitat dominuese në treg dhe keqpërdorimin e këtij statusi. Gjatë këtij trajnimi, eksperti Dr. Pajtim Melani ndër tjerash ka prezantuar për parime të përgjithshme, dominimi I përbashkët, keqpërdorimi I pozitës dominuese; dispozitat ligjore që lidhen me rastet e konkurrencës në lidhje me abuzimin me legjislacionin parësor dhe dytësor të Kosovës; rregullat e BE -së

dhe raste të njohura të BE -së, etj. Kurse më 22 dhe 23 shtator, trajnimi ka qenë i fokusuar në kontrollin e përqendrimeve, ndërsa eksperti i angazhuar për këtë ngjarje ka qene Paul Prisecaru. Ai ka bërë prezantime për llojet e përqendrimeve; logjikën e kontrollimit të tyre, si dhe ka ofruar perspektivën e rregullimit të kësaj çështje në Bashkimin Evropian, duke ofruar shembuj konkret të rasteve të ndryshme

Që të dy këto ngjarje janë mbajtur në një sallë hoteli në Prishtinë, duke respektuar rregullat e vendosura nga Qeveria e Kosovës për të luftuar dhe parandaluar përhapjen e COVID-19. Trajnimet kanë qenë interaktive, me diskutime të thelluara për tema të ndryshme. Si pjesë e Programit të Trajnimeve, një trajnim tjetër dy-ditorë është planifikuar që të mbahet më 6 dhe 7 tetor.


AKK DREJT NJË ORGANIZIMI TË RI TË BRENDSHËM

Në fund të shtatorit, menaxhmenti i AKK-së ka pranuar analizat, gjetjet dhe rekomandimet kyçe lidhur me strukturën e re organizative dhe nevojat në sektorin e IT-së, të cilat janë prezantuar në një tryezë të rumbullakët nga ekspertët e angazhuar nga Projekti "Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore".

Përmes riorganizimit strukturor dhe operacional si dhe përmes krijimit të një sistemi softuerik të menaxhimit të rasteve, synohet që të rritet efikasiteti i punës në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, duke u bazuar në përvojat më të mira të vendeve anëtare të BE-së dhe shteteve të tjera. Tryeza e rumbullakët ka qenë pjesë e fazës së parë së këtij aktiviteti, i cili do të vazhdojë me aspekte të tjera përgjatë këtij viti.

Në fjalën hyrëse të kësaj ngjarje, Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së, Sakip Imeri, ka thënë se Autoriteti ka nevojë që të rrisë kapacitetet e veta në të ardhmen, qoftë në aspektin buxhetor dhe të stafit, dhe se ky studim do të shërbejë kur të avokohet për një gjë të tillë tek autoritetet përgjegjëse të Kosovës. Ai tha se mirëpret faktin që studimi ka marrë për bazë raste të suksesshme të vendeve të BE-së por edhe shteteve të tjera të rajonit.

Këto gjetje dhe rekomandime do të diskutohen edhe me kryetarin dhe komisionin e ri të AKK-së, sapo këta të emërohen.



AKK NË PRITJE TË EMËRIMIT TË KRYETARIT DHE KOMISIONIT TË RI

Që nga 9 qershori i këtij viti, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është duke operuar me kapacitete të kufizuara, për shkak të mungesës së kryetarit dhe komisionit, që janë organi vendimmarrës në institucion.

Kryetari i AKK-së dhe katër anëtarët e tjerë të komisionit propozohen nga Qeveria e Kosovës, kurse zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës me një mandat prej pesë viteve. Ata janë trup vendimmarrës në AKK, që nënkupton hapja dhe mbyllja e çdo rasti kërkon një miratim të tyre.

Përveç mungesës së komisionit, AKK ka vazhduar punën gjatë shtatorit me staf dhe orar të reduktuar për shkak të rritjes së numrit të rasteve me COVID-19 gjatë kësaj periudhe.

Mëso për konkurrencën: PROCEDURAT E HETIMIT TË KONKURENCËS

#Avokimi për
konkurrencën

Teksti i mëposhtëm ofron vetëm shpjegime bazike lidhur me procedurat hetimore që zhvillohen nga Autoriteti. Ky tekst është marrë nga seria e fletushkave informuese të publikuara kohë më parë nga AKK në bashkëpunim me Projektin “Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndhmës Shtetërore”. Më shumë rreth kësaj teme gjeni në fletushkën kushtuar hetimeve:

<https://ak.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/KCA%20%289%29%20%20COMPETITION%20INVESTIGATION%20PROCEDURES-alb.pdf>



Fillimi i procedurës hetimore:

AKK ka një sërë kompetencash hetimore dhe nisja e një procedure nga AKK mund të shfaqet nga disa burime. Së pari, Autoriteti me vet iniciativën e tij mund të fillojë një hetim për marrëveshje të ndaluara (përfshirë kartele të dyshuara) dhe abuzime të dyshuara me një pozitë dominuese në tregun e Kosovës. Në të njëjtën mënyrë, mund të niset një procedurë hetimi në lidhje me përqendrime të caktuara.

Mëso për konkurrencën:
**PROCEDURAT E HETIMIT TË
KONKURRENCËS**

Një burim i dytë janë ankesat. Sipas ligjit, palët e mëposhtme mund të paraqesin një ankesë ose një kërkesë pranë Autoritetit në lidhje me praktika dhe sjellje të pretenduara anti-konkurruese, duke paraqitur informacionin e specifikuar dhe duke kërkuar veprime nga Autoriteti:

- Një person fizik ose juridik
- Një shoqatë profesionale ose ekonomike që ka një interes në këtë çështje
- Odat ekonomike
- Shoqatat e konsumatorëve
- Qeveria e Republikës së Kosovës
- Çdo organ i administratës publike, qendrore dhe lokale

Në vijim të pranimit të një ankesë ose kërkesë, Autoriteti, pavarësisht kësaj mund të vendosë se nuk ka një interes publik për të filluar procedurën e hetimit ose, pas një rishikimi paraprak të tregut përkatës, mund të vendosë që nuk ka asnjë bazë të qëndrueshme për të filluar procedurën e hetimit. Në mënyrë tipike, Autoriteti ka deri në 10 muaj për të refuzuar në këtë mënyrë një ankesë dhe duhet të prezantojë arsye të hollësishme për veprimin e tillë.

Hetimi

Autoriteti ia komunikon vendimin për fillimin e një procedure hetimi (në formën e një "konkluzioni" paraprak) palës kundër së cilës ka filluar procedura, ose parashtruesve të kërkesës për një përqendrim të njoftuar. Në veçanti, pala ose palët kundër të cilave ka filluar procedura u kërkohet të paraqesin brenda 30 ditëve (përveç nëse ky afat zgjatet për arsye të justifikueshme nga Autoriteti) komentet e tyre në lidhje me substancën e hetimit së bashku me informacionin dhe dokumentacionin përkatës.

Për të zhvilluar hetimin e tij, Autoriteti ka të drejtë të kërkojë një sërë informacionesh nga pala kundër së cilës është filluar procedura dhe nga palët e tjera (p.sh. konkurrentët). Në raste të përshtatshme Autoriteti mund të ndër marrë gjithashtu inspektime të pa-njoftuara.

Mëso për konkurrencën:

PROCEDURAT E HETIMIT TË KONKURENCËS

#Avokimi për
konkurrencën

Njoftimi i fakteve

Pasi të ketë mbledhur dhe shqyrtuar informacionin përkatës në kuadër të hetimit, Autoritetit i kërkohet të sigurojë një njoftim me shkrim në lidhje me faktet paraprake të gjetura në procedurën e hetimit, përpara se të caktojë një seancë dëgjimore për çështjen. Brenda një muaji nga marrja e këtij njoftimi, palët në procedurë kanë të drejtë të japin komentet e tyre, të propozojnë dëgjimin e dëshmitarëve shtesë dhe t'i paraqesin Autoritetit prova shtesë.

Vendimi i Autoritetit

Autoritetit i kërkohet të marrë një vendim pas hetimit të tij brenda 90 ditëve nga gjetja e fakteve përkatëse në lidhje me marrëveshjet e ndaluara ose abuzimet me një pozitë dominuese në treg. Vendimet në lidhje me përqendrimet e hetuara duhet të finalizohen nga Autoriteti brenda 90 ditëve nga fillimi i hetimit. Afatet e tjera zbatohen për rrethana specifike të tilla si ndalimi i përjashtimeve në bllok (grup) të marrëveshjeve të caktuara, anulimi i një përqendrimi të miratuar etj. Përjashtimisht, Autoriteti mund të zgjasë afatet e kërkuara për nxjerrje të vendimit deri në 60 ditë.



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY



Funded by
the European Union



Ky buletin është përkrahur nga Projekti EU Support to the Kosovo Competition Authority and State Aid Commission. Përmbajtja e tij është përpiluar në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, dhe është përgjegjësi e tyre dhe e B&S Europe dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.